

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, MAJ 2026

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|------------|-----------------|--|-------------------|--|----------------------------------|---------|
| 1 | 6.5.2026 | Kërkohet koment i Qeverisë Shqiptare lidhur me kritikën se: modeli i zonave ekonomike me lehtësira fiskale konsiderohet tashmë i tejkaluar dhe se, në praktikë, ai rrezikon të përdoret si mekanizëm për krijimin e privilegjeve selektive për subjekte të caktuara, pa sjellë zhvillim real ekonomik, punësim të qëndrueshëm apo të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. dhe si garanton ajo që politikën për zonat ekonomike dhe parqet teknologjike nuk krijojnë trajtim preferencial, por kontribuojnë realisht në zhvillimin ekonomik të vendit. | 19.5.2026 | Kthim përgjigjeje se bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesa për informacion duhet t' i referohet një dokumenti nëpërmjet të cilit kërkohet informacion, psh, strategji, ligj, VKM, Urdhër, Udhëzim etj, sepse ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, statistika, për t'ju përgjigjur pyetjeve, për të bërë komente etj. | Përfunduar | Nuk ka |
| 2 | 14.5.2026 | Kërkohet informacion në lidhje me projektin "Smart Labs" në Shqipëri. | 15.5.2026 | Deleguar AKSHI-t dhe Ministrisë së Arsimit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. | Deleguar | Nuka ka |
| 3 | 14.5.2026 | Kërkohet informacion lidhur me organizimin e edicionit të dytë të festivalit të arkitekturës "Bread & Heart", i cili është zhvilluar më herët në Tiranë gjatë qershorit 2025 dhe, sipas njoftimeve publike dhe pritë të organizohet sërish gjatë muajit qershor 2026. | 15.5.2026 | Deleguar AZHT-së, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. | Deleguar | Nuka ka |
| 4 | 18.5.2026 | Duke iu referuar raporteve të Bashkimit Europian dhe SIGMA/OECD ku evidentohet se struktura organizative e administratës publike është centralizuar me 25 autoritete/agjenci të varura drejtpërdrejt nga Zyra e Kryeministrit, a ka Këshilli i Ministrave një plan ose proces reformimi për decentralizimin, ristrukturimin apo ndryshimin e statusit të këtyre agjencive? Nëse po, ju lutem specifikoni: -Cilët institucione parashikohet të mbeten në varësi të Kryeministrit; -Cilët do të kalojnë në varësi të ministrave; -Apo tjetër formë organizimi? 2- Në këtë reformë a parashikon qeveria ndryshime në statusin, funksionet apo modelin e funksionimit të Agjencisë për Media dhe Informim (MIA) si strukturën që koordinon komunikimin qeveritar në varësi të Zyrës së Kryeministrit? | 2.6.2026 | Procesi i rishikimit të arkitekturës institucionale të administratës shtetërore është pjesë e reformës më të gjerë të administratës publike, e orientuar drejt rritjes së efikasitetit, koherencës institucionale, koordinimit ndër-institucional dhe forcimit të performancës institucionale në funksion të politikëbërjes dhe procesit të integritetit evropian. Në këtë drejtim, përgjatë dy viteve të fundit është zhvilluar një proces analize dhe vlerësimi mbi organizimin institucional të administratës shtetërore, në bashkëpunim dhe dialog të vazhdueshëm me OECD/SIGMA, duke marrë në konsideratë standardet dhe praktikën e vendeve evropiane në organizimin e qendrës së qeverisjes. Procesi është mbështetur, ndër të tjera, në gjetjet dhe rekomandimet e raportit më të fundit të SIGMA-s për performancën e administratës publike në Shqipëri, publikuar në dhjetor 2024, si dokument referues për vlerësimin e kapaciteteve administrative dhe organizimit institucional. Në këtë kuadër, është ndërmarrë një shqyrtim funksional dhe institucional i 29 institucioneve në varësi të Kryeministrit, duke u mbështetur në parimet e organizimit të qendrës së qeverisjes, me synim avancimin drejt qeverisjes efektive, planifikimit të integruar të politikave dhe rritjes së efikasitetit së përgjithshme të administratës shtetërore, dhe forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri. Në përputhje me këto parime, funksionet me natyrë strategjike, ndërsektoriale, ato të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, funksionet e sigurisë kombëtare, si dhe ato të fushave prioritare qeveritare organizohen pranë qendrës së qeverisjes, ndërsa funksionet me natyrë sektoriale, koordinuese vlerësohen në raport me lidhjen funksionale me ministrinë përgjegjëse të linjës. Objektivi final i këtij procesi riorganizimi të ndërmarrë synon të forcojë qendrën e qeverisjes, forcimin e monitorimit të performancës institucionale, si dhe rritjen e efikasitetit institucionale. Procesi nuk prek në asnjë formë reduktimin e kapaciteteve institucionale dhe nuk çënon funksionimin e institucioneve që preken nga ky riorganizim. Gjithashtu, ndryshimet organizative nuk prekin statusin e nëpunësve civilë, funksionet institucionale, apo vazhdimësinë e ushtrimit të përgjegjësiave administrative. Procesi është zhvilluar dhe vijon të zhvillohet në koordinim dhe dialog të hapur me institucionet përkatëse dhe mbi bazën e analizave funksionale, standardeve të qeverisjes së mirë dhe objektivave fundorë të reformës në administratën publike. Në përfundim të këtij ushtrimi vlerësues, është konsideruar që 13 institucione të vliojnë të | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|-----------|--|-----------|--|------------|---------|
| | | | | <p>me përmbajtjen e kësaj kandidate të re, dhe konstatuar që të gjithë funksionet që i mbeten në varësi të Kryeministrit, për shkak të rolit të tyre në ushtrimin e funksioneve të listuara më sipër si funksione që i përkasin qendrës së qeverisjes (horizontale, strategjike, ndërsektoriale, të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, të sigurisë kombëtare dhe prioritetet qeveritare). Ndërkohë, për 16 institucione të tjera është vlerësuar si më funksional dhe efikas organizimi nën ministrinë përkatëse të linjës, me qëllim forcimin e koordinimit sektorial, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes administrative.</p> | | |
| 5 | 20.5.2026 | Kërkohej informacion për ndryshimin e VKM nr. 723 datë 19.11.1998 për rimbursimin e karburantit. | 21.5.2026 | Deleguar Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. | Deleguar | Nuka ka |
| 6 | 22.5.2026 | Kërkohej informacion lidhur me procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit dhe zhvillimit për subjektin "Zvërmec South Adriatic Development", (Leje Ndërtimi për objektin: "Resort turistik në Gadishullin e Zvërmecit", Blloku Rezidencial F1V2, F1V3, F1R6", me vendndodhje në Pishë Poro-Nartë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërmec South Adriatic Development" sh.p.k. | 25.5.2026 | Deleguar Agjencisë për Zhvillimin e Territorit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. | Deleguar | Nuka ka |
| 7 | 22.5.2026 | Kërkohej informacion, në kushtet kur në kartelën e pasurisë është e pasqyruar e drejta e parablerjes se Vilave Gjermane. | 25.5.2026 | Deleguar Korporatës së Investimeve Shqiptare, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. | Deleguar | Nuka ka |
| 8 | 25.5.2026 | <p>1. Kush janë kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozicionin vakant të shpallur; Kryetar i Komisionit të Prokurimeve Publike?</p> <p>2- A ka një kriter se sa duhet të jetë minimalisht numri i kandidatëve në garë për një vend vakant si anëtar i Komisionit të Prokurimeve Publike?</p> <p>3- Sa është numëri i kandidatëve për tri postet vakante për Anëtar të Komisionit të Prokurimeve Publike?</p> | 25.5.2026 | <p>Në përgjigje të kërkesës, informohet se është shpallur njoftimi për aplikim:</p> <p>1. për funksionin e kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili gjendet në linkun: https://www.kryeministria.al/newsroom/njoftim-per-aplikim-26/ si dhe njoftimi për aplikim:</p> <p>2. për 3 (tre) vende vakante në funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili gjendet në linkun: https://www.kryeministria.al/newsroom/njoftim-per-aplikim-25/, ku mund të informoheni lidhur me procedurën përzgjedhëse të kandidatëve për kryetar dhe anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik" (kriteret, dokumentet që kërkohen, procesi i vlerësimit....). Afati për aplikim përfundon në 28.5.2026, ndaj ende nuk ka informacion lidhur me numrin e kandidatëve që kanë aplikuar.</p> | Përfunduar | Nuk ka |